



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:090563
Datë: 02.05.2024
Numri i dokumentit: 05646918

K.Dh.Shk.II.nr.410/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Alba” SH.P.K., me NUI: 810136988, me seli në “Magjistranja Prishtinë - Ferizaj”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra Ligjore Pro Juris Laë Firm L.L.C., kundër debitorit E.G. B.I (N.T. “Charlie”), me NUI: 810136988, me seli në rr. “Pallati i Rinisë” Nr. 94, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valdrin Behrami, avokat në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.65/23, të datës 15.07.2023, me datën 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “Alba” SH.P.K., me NUI: 810136988, me seli në “Magjistranja Prishtinë - Ferizaj”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.65/23, të datës 15.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.65/23, të datës 15.07.2023, në piken I të dispozitivit e ka refuzuar si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori E.G. B.I (N.T. “Charlie”), për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi. Ndërsa në piken II të dispozitivit e ka hedhur si i pa afatshëm prapësimi i debitorit E.G. B.I (N.T. “Charlie”), i parashtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka parashtruar ankesë (me pretendimet si në ankesë), me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, ndaj aktvendimit KPPP.nr.65/23, të datës 15.07.2023, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Alba” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 21-300-002129 të datës 20.09.2021; Faturës Nr. 22-300-000549 të datës 18.03.2022; Faturës Nr. 22-300-000601 të datës 24.03.2022; Faturës Nr. 22-300-000766 të datës 09.04.2022 dhe Faturës Nr. 22-300-000767 të datës 09.04.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin të paguaj borxhin e mbetur prej 5,636.30 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, në të kundërtën realizimi i përmbartimit të ekzekutohet përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit, ndërsa nëse debitorin nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, zyra përmbartimore të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit, të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitorin me datë 11.01.2023 ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, me arsyetimin se nga data e pranimit të urdhrin, në Republikën e Kosovës kanë shënuar festa zyrtare sipas Kalendarit të Festave Zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është shkaktuar konfuzim në afat ligjor, i cili rrjedhimisht ka ndikuar në humbje të afatit për prapësim.

Kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme ia ka bashkangjitur edhe mjetin juridik të prapësimit, në të cilin ka theksuar se faturat e paraqitura sipas këtij urdhri janë të parregullta dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, për shkak se në propozim për përmbartim nuk është treguar kreditori dhe debitorin, si dhe objekti, mjetet dhe koha e përmbushjes së detyrimit, ashtu ky urdhër përmbartimor nuk përmban asnjë element të vlefshmërisë. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet kreditori që t’i paguajë shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ndaj kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, për faktin se konfuziteti për shkak të festave zyrtare nuk mund të jetë shkak që nuk ka mundur të parashikohet ose të evitohet. Ndërsa arsyeja për të bërë prapësim, pas kërkesës për hyrje në marrëveshje të obligimit të borxhit ka për qëllim

vetëm zvarritjen e procedurës përmbarimore dhe zgjatjen e afatit kohor. I ka propozuar gjykatës që kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme ta hedhë poshtë si të palejuar dhe të obligohet debitori që t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.65/23, të datës 15.07.2023 e ka refuzuar si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori E.G. B.I (N.T. “Charlie”), për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi, si dhe e ka refuzuar e ka hedhur si i pa afatshëm prapësimi i debitorit E.G. B.I (N.T. “Charlie”), i parashtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, të Përmbaruesit Privat Isa Gacaferi. Duke vendosur me decidivisht si në dispozitivi të këtij aktvendimi. Ne arsyetim të aktvendimit ka theksuar se Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit është e pabazuar për shkak se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkak të arsyeshem si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta ushtroj prapësimin ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, po ashtu ka theksuar se në këtë rast kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pa bazuar dhe marrë parasysh faktin se Urdhri Përmbarimor është dorëzuar tek debitori me datë 29.12.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 30.12.2022, rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimit, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues”*, dhe atë jo më vonë se deri më 06.01.2023. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshem, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbarimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar si e pabazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, të Përmbaruesit Privat si dhe kur e ka hedhur si i pa afatshëm

prapësimi i debitorit, për arsye se duke u bazuar në dispozitat e nenit 129 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*. Andaj, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkak të arsyeshëm si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta ushtroj prapësimin ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.1257/22 të datës 28.12.2022, ashtu që pretendimet e debitorit se shkak të festave zyrtare ka ndikuar në humbje të afatit të prapësimit nuk i mori për bazë, për faktin se festat zyrtare rregullohen me Ligjin Nr. 03/L-064 Për Festat Zyrtare Në Republikën e Kosovës mbi bazën e të cilës përcaktohet edhe Kalendari i Festave Zyrtare për çdo vit kalendarik. Në rastin konkret palët ndërgjyqëse i kanë pasur të njohura ditët e festave zyrtare në bazë të ligjit përkatës dhe se debitori nuk ka pasur ndonjë shkak të arsyeshëm që nuk do të mund të parashikohet, andaj edhe gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pa bazuar.

Kjo gjykate vlerëson se meqenëse kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori rezulton të jetë e pa bazuar dhe marrë parasysh faktin se Urdhri Përmbartimor është dorëzuar tek debitori me datë 29.12.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 30.12.2022, rezulton se debitori ka pasur afat shtatë (7) ditë që të ushtroj mjetin juridik të prapësimit, në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore me të cilin përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrit përmbartues”*, dhe atë jo më vonë se deri më 06.01.2023. Prandaj nga shkresat e lëndës rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 11.01.2023, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, dhe nga kjo rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 5 (pesë) ditë vonesë.

Po ashtu, Kjo Gjykate vlerëson se e në kuptim të nenit 73, par. 3 të LPP-së përcaktohet se: *“Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*, Andaj, Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e hedhur prapësimin si të pa afatshëm.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore por të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta, dhe rrjedhimisht ankesa e debitorit rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.410/24, me datën 02.05.2024

Gj y q t a r i,
Ramush Bardiqi